



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-74
Nr i faqeve Br. stranica No. pages	-04-
Data: Datum Date:	09, 01, 13
Prishtinë / Pr	



Gjysmëhëna e Kuqe e Kosovës

Memorandum Bashkëpunimi

ndërmjet

Ministrisë së Shëndetësisë

Dhe

OJQ-së “Gjysmëhëna e Kuqe e Kosovës”

Duke u nisur nga interesi i përbashkët për avancimin e cilësisë së mjekësisë dhe të shërbimeve shëndetësore në Kosovë;

Bazuar në objektivin për përparimin e shkëmbimeve shëndetësore me vende tjera në të mirë të rritjes së bashkëpunimit në mes të institucioneve shëndetësore të Kosovës dhe institucioneve relevante me renome botërore;

Me qëllim të përbashkët për krijimin e mundësive të reja për shërbime shëndetësore;

Duke konsideruar si një ndër objektivat prioritare në ushtrimin e veprimtarisë së mjekësisë në përgjithësi dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore në veçanti sipas standardeve evropiane;

Duke pas parasysh suksesin e projektit humanitar të realizuar midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Gjysmëhënës së Kuqë për implantimin e 10 implanteve të veshit, në vlerë prej 200.000 euro.

Duke afirmuar vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandum;

Ministria e Shëndetësisë (MSH), e përfaqësuar nga Ministri Prof. Dr. Ferid AGANI, adresa: Rr. Zagrebit p.n. Prishtinë dhe,

Gjysmëhëna e Kuqe e Kosovës (GJHKK) shoqatë humanitare me nr. 5111078-1 të regjistrimit, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Mr.sc. Adem Ademi, adresa: Rr „Bill Klinton“nr. 21 Lakrishtë- Prishtinë,

lidhin këtë **Memorandum Bashkëpunimi** sipas dispozitave në vijim:

Neni 1 **Qëllimi i marrëveshjes**

Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit në mes të dy palëve, realizimin e projekteve humanitare dhe bashkëpunimin në fushat e tjera të shëndetësisë në pajtim me këtë Memorandum Bashkëpunimi.

Neni 2 **Fushat e bashkëpunimit**

MSH dhe GJHK pajtohen të bashkëpunojnë në këto fusha;

1. Bashkëpunimin në mes të dy palëve në përgatitjen dhe realizimin e projekteve nga fushat përkatëse të Shëndetësisë.
2. Bashkëpunimin në plotësimin e nevojave të spitaleve të Kosovës me mjete dhe teknologji të mjekësisë bashkëkohore.
3. Dërgimin e kuadrove për aftësim profesional në institucionet relevante jashtë Kosovës.
4. Dërgimin për shërimin e personave të sëmurë rëndë jashtë Kosovës që nuk kanë shërim në institucionet publike dhe private të Kosovës, rastet sociale, të varfëritë, në veçanti individ të familjeve të dëshmorëve, në bazë të mundësive të donacioneve të siguruara.
5. Sjelljen e kuadrove profesionale të mjekëve specialistë ndërkombëtar në Kosovë.

6. Bashkëpunim dhe fushata tematike ndër institucionale për të mirën e përgjithshme si: mbrojtja e shëndetit publik, të drejtat shëndetësore.
7. Lehtësimi i implementimit të hulumtimeve dhe studimeve të ndryshme me rëndësi relevante për banorët dhe autoritetet e Ministrisë së Shëndetësisë;

Neni 3

Obligimet e palëve

1. MSH i afron GJHKK-së mbështetje me ide dhe projekte konkrete nga sfera e shëndetësisë kosovare.
2. MSH e sugjeron GJHKK për projektet, nevojat dhe kërkesat më prioritare në sferën e shëndetësisë që duhet realizuar.
3. GJHKK mban të drejtën e llogaritjes së shpenzimeve materiale vjetore që janë të domosdoshme për ti realizuar projektet e përbashkëta humanitare me MSH, si pjesë e kostos së projektit humanitar.
4. GJHKK e njofton me shkrim MSH, për kontaktet, bashkëpunimin me institucionet relevante dhe realizimin e projekteve.

Neni 4

Vlerësimi i zbatimit të memorandumit

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht funksionimin e mekanizmave të bashkëpunimit nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti me shkrim pranë titullarëve të dyja palëve.
2. Raporti përfundimtar i përbashkët përmban, krahas të dhënave për mënyrën e zbatimit të memorandumit, edhe rekomandimet konkrete për adresimin e nevojave të evidentuara.

Neni 5

Kostot financiare

Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të buxhetit që Ministria e Shëndetësisë ka në dispozicion.

Neni 6

Kohëzgjatja e memorandumit të Bashkëpunimit

1. Memorandumi i bashkëpunimit është vullnet i dy palëve për përmirësimin e gjendjes në sektorin e shëndetësisë kosovare dhe është proces afatgjatë humanitar që fillimisht nënshkruhet për afatin tre vjeçar.
2. Memorandumi i bashkëpunimit në mes të dy palëve mund të ndryshohet dhe plotësohet me shkrim në rast nevoje, me pëlqimin e të dyja palëve.

Neni 7
Gjuha e përdorur

Dokumenti i memorandumit të bashkëpunimit në mes Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Gjysmëhënës së Kuqe të Kosovës është shkruar në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.

Neni 8
Pëlqimi i palëve

1. Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të marrëveshjes.
2. Mospajtimet ose interpretime eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshjeje do të rregullohen në mënyrë miqësore, me marrëveshje konsensuale.


Neni 9

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, një prej të cilave arkivohen në Ministrinë e Shëndetësisë dhe një për GJHKK.

Neni 10

Ky memorandum nënshkruhet me datë 08.01.13 Prishtinë, dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Për: Ministrin e Shëndetësisë


Prof. Dr. Ferid Agani
Ministër i Shëndetësisë

Për: GJHKK


Mr. sc. Adem Ademi
Drejtori Ekzekutiv

